

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6261  
E enjte, 11 mars 2021  
çmimi 0.40 €

KMDLNj, veteranëve të UÇK-së: Mos kaloni nëpër Serbi, mund të arrestoheni | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", MILAZIM KRASNIQI | FAQE 4-5

## KANDIDATURAT PËR KRYETAR TË LDK-së TREGOJNË KRIZËN E KONCEPTIT POLITIK TË SAJ



Një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Milazim Krasniqi, ka bërë me dije se kjo parti kuvendin e 14 marsit duhet ta shfrytëzojë për rimëkëmbje të

mirëfilltë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se këtë kuvend LDK-ja duhet ta shfrytëzojë edhe për ta mobilizuar anëtarësinë e saj dhe rikthimin e atyre

që kanë braktisur këtë parti. Duke folur për kandidaturat e propozuara për kryetar të LDK-së, Krasniqi ka thënë se ato janë figura me profile tërësisht të ndryshme prej njëra-tjetrës

### HAZIRI: DO TA RIKTHEJ LDK-NË PARTI TË PARË | FAQE 3

Lutfi Haziri ka shpallur të martën kandidaturën për kryetar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Kuvendin Zgjedhor që do të mbahet këtë të diel. Ai ka theksuar se zgjedhjet në LDK nuk duhet të jenë zgjedhje për të eliminuar njerëz, por për të bashkuar. Tre brezat e artë të LDK-së, ai i



politikave të rezistencës, brezi i republikës dhe brezi i Kosovës evropiane, duhet të vazhdojnë të kenë kohezion të plotë. "Këta janë besim për mua, për ta kthyer LDK-në aty ku e ka vendin, si partia e parë", ka thënë Haziri

### MBI 50 000 PUNËTORË KANË HUMBUR VENDET E PUNËS | FAQE 9



### OPINION

JO PROPAGANDË, SHTIMI DHE SHPEJTIMI I VAKSINIMIT JANË POLITIKA MË E MIRË EKONOMIKE E SOCIALE | F. 6

Prof. Lisen BASHKURTI



### AKTUALE




PAS ZGJEDHJEVE TË 14 SHKURTIT, HOXHAJ NIS VIZITAT NËPËR DEGËT E PDK-së | F. 7

VAZHDOJNË PUNIMET PËR NDËRTIMIN E QENDRËS SË AUTIZMIT DHE SINDROMËS DOWN NË PRISHTINË | F. 6

### EKONOMI

KONFISKOHEN 700 KILOGRAMË MISH NË FERIZAJ | F. 9

OEAK-u: NDËRMJETËSIMI TË PËRDORËT SI FORMË PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE TË PUNËS | F. 9



### SPORT

PRISHTINA MERR KRYESIMIN NË SUPERLIGË | F. 12

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Johnsoni mohon ndalimin e eksportit të vaksinave

LONDËR, 10 MARS - Kryeministri britanik Boris Johnson i hodhi poshtë pohimet e presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel, se Britania i ka ndaluar eksportet e vaksinave kundër koronavirusit.

Johnsoni ka thënë se Britania e kundërshton nacionalizmin mbi vaksinat "në të gjitha format e tij". Duke iu adresuar Parlamentit britanik, Johnson kërkoi edhe nga ligjvënësit t'i kundërshtojnë pretendimet e Brukselit. "Ne mund të jemi krenarë për mbështetjen që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë përgjigjes

ndërkombëtare kundër koronavirusit. Andaj, dua t'i korrigjoj sugjerimet e presidentit të Këshillit Evropian se Mbretëria e Bashkuar i ka bllokuar eksportet e vaksinave. Më lejoni të jem i qartë: ne nuk kemi bllokuar eksportin e ndonjë vaksine e as të përbërësve të vaksinës", ka deklaruar Johnsoni.

Autoritetet britanike thirrën të mërkurën një zyrtar të BE-së në Zyrën e Jashtme, për t'i shpjeguar deklaratat e Michelit. Michel ka pohuar të martën se "Mbretëria e Bashkuar dhe

Shtetet e Bashkuara kanë vendosur ndalesa të plota mbi eksportin e vaksinave ose të përbërësve të vaksinave, që prodhohen në vendet e tyre".

Argumentet vijnë në kohën kur udhëheqësit evropianë janë nën presion për shpërndarje të ngadalshme të vaksinave. BE-ja është përballur me probleme furnizimi me prodhuesit Pfizer/BioNTech, Moderna dhe Oxford/AstraZeneca.

Në Mbretërinë e Bashkuar, ndërkaq, më shumë se 22.5 milionë njerëz, rreth një e treta e popullsisë kanë marrë dozën e parë të vaksinës.



## BE-ja do të marrë vakcina shtesë për vatrat e koronavirusit

BRUKSEL, 10 MARS - Bashkimi Evropian do të marrë katër milionë doza shtesë të vaksinës Pfizer/BioNTech kundër koronavirusit, gjatë dy javëve të ardhshme. Kështu ka thënë të mërkurën presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen.

Dërgesa do të shkojë në rajonet e prekura kufitare brenda bllokut për ta ndihmuar lëvizjen e lirë të mallrave dhe njerëzve. Sipas saj, dozat do të dorëzohen "përpara fundit të marsit".

Njoftimi vjen në kohën kur Komisioni Evropian po përpqet t'i bindë së paku gjashtë shtete anëtare, përfshirë Gjermaninë e



Austrinë që t'i heqin kufizimet në kufij, të vendosura për shkak të numrit të lartë të

rasteve me koronavirus në vendet fqinje. "Duke i përdorur atje ku është më e nevojshme,

veçanërisht në rajonet kufitare, këto doza të vaksinës do të ndihmojnë edhe në sigurimin ose rivendosjen e lëvizjes së lirë të mallrave dhe njerëzve", ka deklaruar von der Leyen.

Deklarata e saj, po ashtu, thekson se vakcina Pfizer/BioNTech po tregon se është "shumë e efektshme" ndaj varianteve të reja të koronavirusit.

Disa vatra në Evropë, përfshirë Tirollin në Austri, Nicën në Francë, Bolzanon në Itali dhe pjesë të Bavarisë dhe Saksonisë në Gjermani, kanë përjetuar rritje të infeksioneve dhe të shtrimeve në spital javën e fundit, tha Komisioni

Evropian.

BE-ja ka gjashtë kontrata për më shumë se dy miliardë doza vaksinash, për të imunizuar 450 milionë njerëzit e saj.

BE-ja, megjithatë, është kritikuar për ritëm të ngadalshëm të vaksinimit, por zyrtarët janë arsyetuar me problemet në furnizimin me vakcina.

Franca ka numrin më të madh të të infektuarve në Bashkimin Evropian: rreth katër milionë. Italia prin në BE me numër të viktimave: mbi 100 000.

Në të gjithë botën, koronavirusi ka prekur mbi 117 milionë njerëz. Prej tyre, mbi 2.6 milionë kanë vdekur dhe mbi 66 milionë janë shëruar.

## Franca do të ndërtojë memorial për viktimat e terrorizmit

PARIS, 10 MARS - Franca deri në vitin 2027 do të ndërtojë një memorial kombëtar për viktimat e terrorizmit, njoftoi të mërkurën Zyra e Presidencës franceze. Sipas saj, një muze për terrorizmin bashkëkohor, që nga vitet 1960 dhe 1970, është planifikuar gjithashtu.

Lokacioni i tyre nuk është përcaktuar ende.

Vitet e fundit zona e Parisit dhe viteti bregdetar i Nicës janë



prekur veçanërisht nga sulmet e përgjakshme terroriste.

Presidenti francez Emmanuel Macron planifikon t'i

përkujtojë viktimat e terrorizmit në një shërbim përkujtimor kombëtar, që do të mbahet të enjten në Paris. Mbi 250 njerëz janë vrarë vitet e fundit në sulmet terroriste në Francë, për të cilat janë fajësuar militantët islamikë.

Burime nga pallati presidencial Elysee kanë thënë se kërcënimi i terrorizmit në këtë vend mbetet shumë i lartë. Që nga viti 2017, kur Macron i ka fituar zgjedhjet presidenciale, 33

sulme janë parandaluar në Francë, kanë thënë burimet për agjencinë e lajmeve DPA.

Sulmet terroriste kanë goditur rëndë Francën edhe gjatë vitit të kaluar. Në tetor, një 21-vjeçar me prejardhje nga Tunizia ka vrarë tre njerëz me thikë, në një kishë të Nicës. Paraprakisht, një mësuesi i është prerë koka në një lagje në rrethinë të Parisit. Të dyja aktet kanë shkaktuar zemërim global.

## Kina dhe Rusia synojnë ndërtimin e stacionit hapësinor hënor

PEKIN, 10 MARS - Kina dhe Rusia kanë bërë të ditura planet për të ndërtuar stacion hapësinor hënor. Agjencia ruse e hapësirës "Roskosmos" ka thënë se ka nënshkruar

marrëveshje me Administratën Kombëtare të Hapësirës në Kinë, për të zhvilluar kërkime në sipërfaqen e Hënës, në orbitë apo në të dyja. Në deklaratën e këtyre dy vendeve

është thënë se ky stacion do të jetë i qashtë për përdorim edhe nga kombet e tjera. Lajmi vjen teksa Rusia përgatitet për ta shënuar 60-vjetorin e fluturimit të një njeriu në

hapësirë. Stacioni Ndërkombëtar Shkencor në Hënë do të kryejë një mori kërkimesh shkencore, duke përfshirë analizimin e Hënës, është thënë në deklaratë.



Lutfi Haziri ka zyrtarizuar kandidaturën për kryetar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)

## Haziri: Do ta rikthej LDK-në parti të parë

Lutfi Haziri ka shpallur të martën kandidaturën për kryetar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Kuvendin Zgjedhor që do të mbahet këtë të diel. Ai ka theksuar se zgjedhjet në LDK nuk duhet të jenë zgjedhje për të eliminuar njerëz, por për të bashkuar. Tre brezat e artë të LDK-së, ai i politikave të rezistencës, brezi i republikës dhe brezi i Kosovës evropiane, duhet të vazhdojnë të kenë kohezion të plotë. “Këta janë besim për mua, për ta kthyer LDK-në aty ku e ka vendin, si partia e parë”, ka thënë Haziri



**EPOKA  
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 MARS - Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, ka zyrtarizuar të martën kandidaturën për kryetar të kësaj partie. Më 14 mars LDK-ja do të mbajë kuvendin zgjedhor për kryetar të ri të saj. Për kandidimin e tij për kryetar të LDK-së, Haziri ka thënë se ishte një kërkesë e kamotshme edhe e strukturave të partisë në nivel të vendit. “Kësaj radhe kam vendosur që ta dëgjoj zërin e tyre për të kandiduar për kryetar të LDK-së”, është shprehur ai në konferencën për media.

Ai ka thënë se do ta rikthejë LDK-në aty ku e ka vendin. “Tri postulatet e shenjta të LDK-së, liria e arritur me sakrificë dhe kryengritje të armatosur, pavarësia e shpallur de jure më 17 shkurt dhe demokracia e Kosovës, mbeten postulate të

cilat do të besoj e punoj për ta rikthyer LDK-në aty ku e ka vendin. Një LDK pa të cilën nuk ka as zgjidhje e as zgjedhje. Jam krenar që për 31 vjet të ecjes sime me besnikëri e lojalitet në rreshtin e madh të Ibrahim Rugovës, të partisë më të vjetër, më të organizuar, më të strukturuar dhe partisë së vetme që këtij vendi i dha formë, besim e shpresë se republika jonë mund dhe duhet të zhvillohet për t’u bërë e barabartë me të gjithë të tjerët”, ka thënë ai.

Haziri ka theksuar se çdo gjeneratë ka cilësitë e veta, dijen e vet dhe kulturën e vet që mund të japin rezultate. “Ne e vlerësojmë shumë gjeneratën e re, por ne, po ashtu, e vlerësojmë përvojën, rezistencën e qëndrueshmërisë së gjeneratës së vjetër dhe gjeneratës së mesme të LDK-së, e cila, sidoqoftë, po e mban sot trajektoren e partisë. Tre brezat e artë të LDK-së, ai i politikave

të rezistencës, brezi i republikës dhe brezi i Kosovës evropiane, duhet të vazhdojnë të kenë kohezion të plotë. Këta janë besim për mua, për ta kthyer LDK-në aty ku e ka vendin, si partia e parë”, ka thënë Haziri. Ai ka theksuar se zgjedhjet në LDK nuk duhet të jenë zgjedhje për të eliminuar njerëz. “Këto duhet të jenë zgjedhje, ku nuk eliminohen njerëzit, por bashkohen për t’u bërë më shumë, zgjedhje ku respektohet veprimtari, por i hapet dera të

riut, zgjedhje ku gratë vendosin e burrat implementojnë, zgjedhje ku të rinjtë kërkojnë dhe burrat e gratë implementojnë”, është shprehur Haziri, duke shtuar se LDK-së i duhet unitet.

Për kontributin e dhënë në LDK, ai ka falënderuar Isa Mustafën, Fatmir Sejdiun, Nexhat Dacin dhe Kolë Berishën. “Po vjen koha për ndryshim dhe ndryshimi nuk ka alternativë, do të ndodhë me rikthimin e madh të LDK-së si

parti e parë. Ky rikthim i madh, nënkupton besim te partnerët, shpresë te popullata jonë dhe guxim e përgjegjësi për ta zhvilluar vendin tonë. Në cilësinë e kandidatit të LDK-së më 14 mars, jap zotimin tim për vlerësim të drejtë, reformë të bazuar në meritë, konkurrencë dhe hapje për brezin evropian të LDK-së”, ka theksuar Haziri. Kandidaturat për të parin e LDK-së i kanë shpallur edhe Lumir Abdixhiku, Anton Quni dhe Besian Mustafa.

## Ndalohe dy persona nën dyshimet për manipulim të votave

PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se të martën ka ndaluar dy persona, me inicialet A. K dhe S.M, nën dyshimin për veprat penale “Keqpërdorim i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve” dhe “Dhënie apo marrje e ryshfetit në lidhje me votimin”. “Prokurori i Shtetit gjatë ditës së sotme do të parashtojë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit për dy personat e lartcekur për shkak të dyshimit se të njëjtët kanë kryer veprat si më lart”, thuhet në njoftim të Prokurorisë Speciale.

Në mediat lokale në Kosovë ditë më parë u publikua një video-incizim, ku pretendohet për falsifikim të votave të kandidatëve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për

zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Pas ngritjes së dyshimeve për manipulim të votave në zgjedhjet e 14 shkurtit, Meliza Haradinaj-Stublla të martën, më 9 mars, dha dorëheqje nga drejtimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës si dhe nga funksionet në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës.

Dorëheqja e Haradinaj-Stubllës erdhi një ditë pasi Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) i miratoi si të bazuara disa nga apelet e kandidatëve dhe subjekteve politike, që morën pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit.

Një nga apelet kishte të bënte me dyshimet për manipulim të



votave me kusht dhe me postë në favor të Haradinaj-Stubllës. PZAP-ja ka urdhëruar

rinumërimin e votave me kusht dhe me postë për kandidatët e AAK-së. Ky proces, që është

drejt përfundimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, po mbikëqyret nga hetuesit.



FLET PËR "EPOKËN E RE", MILAZIM KRASNIQI

# Kandidaturat për kryetar të LDK-së tregojnë krizën e konceptit politik të saj

Një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Milazim Krasniqi, ka bërë me dije se kjo parti kuvendin e 14 marsit duhet ta shfrytëzojë për rimëkëmbje të mirëfilltë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka deklaruar se këtë kuvend LDK-ja duhet ta shfrytëzojë edhe për ta mobilizuar anëtarësinë e saj dhe rikthimin e atyre që kanë braktisur këtë parti. Duke folur për kandidaturat e propozuara për kryetar të LDK-së, Krasniqi ka thënë se ato janë figura me profile tërësisht të ndryshme prej njëra-tjetrës

Hazirin, apo do të zgjedhin konceptin reformist me Lumir Abdixhikun, mbetet në dorën e delegatëve", ka thënë Krasniqi. Sipas tij, opozita duhet të qëndrojë në sallën e Kuvendit në momentin e zgjedhjes së presidentit. "Jam i bindur që edhe LDK-ja dhe PDK-ja bëjnë veprim korrekt nëse rrinë në sallë dhe japin mundësinë që Vjosa Osmani të zgjedhjet presidente. Pastaj ata mund të bëjnë një opozitarizëm konstruktiv brenda institucioneve dhe jo të jenë bllokuese", ka thënë Krasniqi.

rezultat i kësaj ka ardhur deri tek akumulimi i problemeve dhe me këtë ka ndodhur shpëputja nga elektorati i saj. Natyrisht se kjo ka qenë e shoqëruar edhe me gabime kardinale të udhëheqjes së LDK-së, veçmas të Isa Mustafës, i cili ka treguar një kokëfortësi irracionale për refuzimin e asaj çfarë do të duhej të ishte interesi i LDK-së.

**"Epoka e re":** Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka paralajmëruar dorëheqjen dhe për këtë arsye e kanë caktuar më 14 mars mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor për zgjedhjen e kryetarit të ri. Si e shihni mbarëvajtjen e këtij kuvendi?

**Krasniqi:** Unë dëshiroj dhe shpresoj që ai kuvend të shkojë mirë dhe mbarë, në mënyrë që të shndërrohet në një rast të rimëkëmbjes së mirëfilltë të LDK-së. Sepse ata kanë ardhur në një pikë kritike. Për këtë arsye besoj se do ta mbledhin mendjen dhe nuk do të lejojnë përçarje të mëtejshme. Ata do të

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 10 MARS** - Milazim Krasniqi, një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), beson se Kuvendi i 14 marsit do të shkojë mbarë për këtë subjekt politik. Ai ka thënë se LDK-ja këtë kuvend duhet ta shfrytëzojë për ta mobilizuar anëtarësinë dhe për t'i rikthyer ata që e kanë braktisur këtë parti.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Krasniqi ka deklaruar se kjo parti nuk duhet të lejojë përçarje të reja në këtë kuvend. "Unë dëshiroj dhe shpresoj që ai kuvend të shkojë

mirë dhe mbarë në mënyrë që të shndërrohet në një rast të rimëkëmbjes së mirëfilltë të LDK-së. Sepse ata kanë ardhur në një pikë kritike. Për këtë arsye besoj se do ta mbledhin mendjen dhe nuk do të lejojnë përçarje të mëtejshme. Ata do të duhej të shfrytëzojnë këtë kuvend për ta mobilizuar anëtarësinë dhe për të bërë përpjekje që ta kthejnë atë pjesë të anëtarësisë që është shkëputur prej tyre në zgjedhjet e 14 shkurtit", ka thënë Krasniqi.

Ai ka vlerësuar se kësaj partie i duhen reforma të thella. "LDK-së i duhet një reformë rrënjësore në aspektin

strukturor dhe administrativ, por i duhet edhe një narracion tjetër për gjeneratat e reja, nëse dëshiron që të bëhet atraktive për ta", është shprehur ai. Duke folur për kandidaturat e propozuara për kryetar të partisë, ai ka thënë se ato janë figura me profile tërësisht të ndryshme prej njëra-tjetrës. "LDK-ja ka tri kandidatura shumë interesante. Secila prej tyre është një storie dhe tash varet nga mençuria e delegatëve të kuvendit se çfarë do të zgjedhin. Se a do t'i zgjedhin ato vlerat e periudhës të luftës me Anton Qunin, se a do t'i zgjedhin vlerat tradicionale rugoviste me Lutfi

**"Epoka e re":** Z. Krasniqi, në zgjedhjet e 14 shkurtit LDK-ja pothuajse është përgjysmuar në elektorat. Çfarë mendoni se ka ndikuar në këtë rënie të LDK-së?

**Krasniqi:** Për këto vite LDK-ja ka neglizhuar procesin e reformave, procesin e përtëritjes së partisë, procesin e ndryshimeve programore në pajtim me ndryshimet që kanë ndodhur në shoqëri. Dhe si



Anton Quni, Lutfi Haziri dhe Lumir Abdixhikut?

**Krasniqi:** Këto tri kandidatura në mënyrë simbolike tregojnë krizën e konceptit politik të LDK-së. Pse? Sepse janë tri figura me profile tërësisht të ndryshme prej njëra-tjetrës. Anton Quni vjen prej luftës çlirimtare dhe si figurë e tillë ka qenë shumë i dobishëm për LDK-në në vitet 2000-2005 kur LDK-ja akuzohej se ka sabotuar luftën. Një figurë e tillë në hierarkinë e lartë të partisë do të ishte shumë e dobishme për t'i amortizuar akuzat ndaj LDK-së. Mirëpo sot, pas 20 vjetëve, unë nuk shoh se me çfarë idesh Anton Quni mund ta reformojë partinë. Kurse Lutfi Haziri mendoj se është njëra nga figurat prominente të LDK-së, një rugovist i dëshmuar, një njeri që ka treguar një konsekuencë të jashtëzakonshme në parti. Në këtë rast, problemi i LDK-së është në koncept. Nëse LDK-ja aspiron që ta ruajë anëtarësinë ekzistuese dhe anëtarësinë tradicionale që është pasivizuar, Lutfi Haziri mund të jetë figura më e përshtatshme. Në anën tjetër, Lumir Abdixhiku është një figurë e re. Nëse LDK-ja aspiron që të kapë një hapësirë të re të elektoratit, qoftë rininë, qoftë ata që nuk janë në LDK, ai mund të jetë më shumë një figurë magnetizuese për atë tip të elektoratit. Pra, LDK-ja ka tri kandidatura shumë interesante ku secila prej tyre është një storie dhe tash varet nga mençuria e delegatëve të kuvendit se çfarë do të

zgjedhin. Se a do t'i zgjedhin ato vlerat e periudhës së luftës me Anton Qunin, apo vlerat tradicionale rugoviste me Lutfi Hazirin ose do të zgjedhin konceptin reformist me Lumir Abdixhikun, mbetet në dorën e delegatëve.

**"Epoka e re":** Në këtë situatë, cili prej këtyre kandidatëve do të ishte më i duhuri për LDK-në?

**Krasniqi:** Unë vlerësoj se detyra e zgjedhjes së kryetarit i takon ekskluzivisht Kuvendit të LDK-së dhe nuk do të dëshiroj të interferoj në vendimin e delegatëve të atij kuvendi. Prandaj, do të rezervohem nga deklaratat për emra të përveçëm në kuptimin e favorizimit. Është publikisht e njohur që unë Lutfi Hazrin e kam mik të vjetër dhe preferenca personale imja mund të jetë ai për shkak të miqësisë. Por këtu unë nuk po flas për miqësi, por për konceptim politik që duhet ta artikulojë LDK-ja në atë kuvend. Është e mundshme që në kuvend të ketë edhe kandidatura të tjera të cilat mund ta begatojnë kuvendin zgjedhor. Personalisht mendoj se z. Quni, z. Haziri dhe z. Abdixhiku meritojnë respektin e anëtarësisë së LDK-së, sepse kanë dalë si kandidatë në një moment shumë të vështirë. Ata nuk kanë dalë tash për të marrë favore, sepse nuk e kanë fare të sigurt rezultatit, por kanë dalë me vullnetin që të bëjnë diçka të mirë për LDK-në dhe në këtë aspekt mendoj se anëtarësia e LDK-së duhet ta vlerësojë.

**"Epoka e re":** Pa zgjedhjes të kryetarit të ri, cilat janë veprimet që duhet t'i ndërmarrë ai për reformimin e kësaj partie?

**Krasniqi:** Kjo është pyetja më esenciale. Së pari, kryetari i ri do të duhej të fillonte një proces të ndryshimit të statutit dhe programit, duke i përshtatur me realitetet e reja dhe me orientimin e LDK-së si parti e qendrës së djathë. Së dyti, kryetari i ri do të duhej ta fillonte procesin e përgatitjes së një kuvendi të ri, i cili do të duhej të mbahej para zgjedhjeve lokale për ta përtërirë partinë në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe nivelin lokal. Kjo më së miri do të ishte që të zhvillohej sipas parimit 'një anëtar një votë'. Në këtë drejtim, jam i bindur që shumë prej funksionarëve të lodhur të LDK-së do të shmangeshin dhe do të vinin në shprehje kuadrot e reja për ta dhënë kontributin e tyre në LDK. Së treti, LDK-ja duhet të fillojë ta ndërtojë një narracion më konkret për historinë e saj dhe për figurat e saj. Sepse LDK-ja në mënyrën më të pafytyrë për këto vite i ka harruar themeluesit e saj, i ka harruar kontributet e mëdha që kanë dhënë gjeneratat e tëra të njerëzve për fuqizimin e LDK-së, i ka harruar bashkatdhetarët që kanë pasur rol vendimtar për mbajtjen e jetës sociale dhe ekonomike në Kosovë gjatë viteve të okupimit. Pra, është mbyllur deri në atë masë sa është shndërruar në parti të disa pashallarëve lokalë. LDK-së i dihet një reformë rrënjësore në aspektin strukturor dhe

administrativ, por i duhet edhe një narracion tjetër për gjeneratat e reja nëse dëshirojnë që të bëhet atraktive për ta.

**"Epoka e re":** Lidërshipi i ri i LDK-së si duhet të sillet me ish-kandidaten e tyre për kryeministër, Vjosa Osmani, e cila tash është kandidatë për presidente?

**Krasniqi:** Personalisht mendoj se fitorja e LV-së dhe Vjosa Osmanit më 14 shkurt është fitore bindëse dhe është fitore e pastër. Rezultati secilit i ka treguar që ata kanë marrë një mandat të pastër për ta qeverisur Kosovën. Pjesa tjetër është çështje teknike. Se a do të rrinë në Kuvend apo jo, kjo nuk e zhbën faktin që LV-ja dhe Vjosa Osmani janë fitues të zgjedhjeve. Prandaj, jam i bindur që edhe LDK-ja edhe PDK-ja bëjnë veprim korrekt nëse rrinë në sallë dhe japin mundësinë që Vjosa Osmani të zgjedhet presidente. Pastaj ata mund të bëjnë një opizitarizëm konstruktiv brenda institucioneve dhe jo të jenë bllokuese. Filozofia e bllokimit ka qenë filozofi e LV-së dhe këto parti nuk do të duhej ta riciklonin atë, por do të duhej të jenë konstruktive. Është interes shtetëror i Kosovës konsolidimi sa më i shpejtë i institucioneve, pastaj të vazhdojë gara politike. Në fund të këtij viti janë zgjedhjet lokale dhe secili e ka shansin ta përmirësojë gabimin dhe të dalë me rezultate më të mira në zgjedhjet e ardhshme.

duhej të shfrytëzojnë këtë kuvend për të mobilizuar anëtarësinë dhe për të bërë përpjekje që ta kthejnë atë pjesë të anëtarësisë që është shkëputur prej tyre në zgjedhjet e 14 shkurtit.

**"Epoka e re":** Deri më tani kemi parë tri kandidatura zyrtare për kryetar të LDK-së. Cili është komenti juaj për kandidaturën e

## LDK-ja dhe PDK-ja kërkesën e AAK-së për rinumërimin e votave e quajnë morale dhe legjitime

PRISHTINË, 10 MARS - Kërkesën e anëtarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ), Ibrahim Selmanaj, për rinumërim total të votave, anëtarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Partisë Demokratike të Kosovës në KQZ e kanë quajtur legjitime dhe morale.

Anëtari i Lidhjes Demokratike të Kosovës në Komisionin Qendror Zgjedhor, Sami Hamiti, ka thënë se kjo kërkesë vjen pas situatës që ka ndodhur ditët e fundit. Sipas tij, nuk është duke u kërkuar rinumërim për rezultatit e subjekteve politike. "Kërkesa e Ibrahimit për rinumërim, sa shoh unë, vjen pas situatës që ka ndodhur ditët e fundit. Askush nuk ka kërkuar

rinumërim për rezultatit e subjekteve politike", ka thënë ai duke e quajtur kërkesën e Selmanajt 'morale'. "Kjo është një kërkesë morale nga ana e përfaqësuesit të AAK-së në kuptimin e asaj që të zbulohet çdo gjë rreth kandidatëve", ka thënë ai.

Edhe Arianit Elshani nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka thënë se kjo kërkesë është legjitime. "U tha që kërkesa e Selmanajt është politike dhe mund të jetë, mirëpo është legjitime. Ka disa fakte, videoincizime, rinumërimi ka konstatuar që ka pasur manipulime", ka thënë Elshani. Ai, po ashtu, ka thënë se shpreson që ky proces të përmbyllet për të parë nëse ka mospërputhje të tjera të rezultateve.



## Asgjësohen 5 000 kg produkte ushqimore dhe 150 kg duhan në Gjakovë

**GJAKOVË, 10 MARS (ER)** - Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës ka asgjësuar 5 000 kilogramë produkte ushqimore dhe 150 kilogramë duhan që nuk ishin të sigurta për konsum. E gjithë kjo ka ardhur pas një bashkëpunimi në mes të inspektorëve me policinë e Gjakovës.

Drejtori për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës, Fazli Hoxha, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije se si drejtori

nuk do të ndalen sa iu përket inspektimeve, sepse synim kanë mbrojtjen e konsumatorit. "Inspektorët në kuadër të Drejtorisë për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës gjatë ditëve të fundit kanë bërë një punë intensive, e cila ka rezultuar me asgjësimin e 150 kilogramëve të duhanit, që paraprakisht ishin sekuestruar nga ana e inspektorëve, pas një bashkëpunimi me policinë e Gjakovës. Gjithashtu, inspektorët e tregut, të

sanitarisë dhe të veterinarisë kanë asgjësuar rreth 5 000 kilogramë të produkteve të llojit ushqimor, që nuk ishin të sigurta për konsum. Po ashtu, inspektorët kanë bërë edhe sekuestrimin e 474 litrave që përmbanin produkte ushqimore, të cilat ishin në treg për shitje pa i plotësuar kushtet e përcaktuara ligjore. Nuk do të ndalemi sa iu përket inspektimeve, sepse synim kemi mbrojtjen e konsumatorit", ka shkruar Hoxhaj.



## Gjilani ka aktualisht 326 raste aktive me Covid-19



**GJILAN, 10 MARS (ER)** - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19, nën udhëheqjen e nënkryetarit të Gjilanit, Arbër Ismajli, ka mbajtur takimin për vlerësimin e situatës për dy ditët e fundit. Ismajli ka

njoftuar se Gjilani aktualisht ka 326 raste aktive, duke apeluar qytetarët dhe bizneset që japin shërbime që të vazhdojnë t'i respektojnë masat, vendosjen e maskës dhe mbajtjen e distancës. Pasqyra e përgjithshme në

Gjilan që prej fillimit të pandemisë është si vijon: nga 14 076 mostra, 4 016 kanë rezultuar pozitivë, 3 578 janë shëruar, 112 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 326 raste janë aktive, të hospitalizuara me Covid janë 68 persona.

## Ekzekutohen pagesat e subvencioneve për biznese dhe OJQ në Prizren

**PRIZREN, 10 MARS (ER)** - Drejtoria për Ekonomi dhe Financa në Komunën e Prizrenit ka njoftuar se tanimë ka përfunduar ekzekutimi i pagesave për biznese dhe OJQ që kishin përfituar nga subvencionet e vitit 2020. "Këto mjete financiare nuk ishin transferuar për shkak të limitit bankar të shtetit dhe për shkak të gabimeve në

dokumentacionet e dorëzuara për pagesë. Kujtojmë se Komuna e Prizrenit kishte ndarë 1.1 milion euro subvencione me qëllim të përkrahjes së bizneseve dhe OJQ-ve të dëmtuara ekonomikisht për shkak të pandemisë Covid-19, nga e cila kanë përfituar 117 biznese dhe 65 organizata dhe individë", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



## Vazhdojnë punimet për ndërtimin e Qendrës së Autizmit dhe Sindromës Down në Prishtinë

**PRISHTINË, 10 MARS (ER)** - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se janë duke vazhduar punimet sipas planit dinamik për ndërtimin e Qendrës së Autizmit dhe Sindromës Down në Prishtinë, e para e këtij lloji në Kosovë. Ai ka theksuar se ndërtimi i kësaj qendre po mundësohet me bashkëfinancim nga Komuna e Prishtinës, Agjencia TIKa

dhe shoqata "Autizmi" dhe "Down Syndrome Kosova". "Qendra do ta ofrojë infrastrukturën dhe shërbimet për fëmijët dhe individët me sindromën Down e Autizëm, e që kanë nevojë për mbështetje dhe trajtim të specializuar, për ta zhvilluar potencialin e tyre maksimal drejt një jete të shëndetshme, pavarur dhe gjithëpërfshirëse", ka thënë Ahmeti.



# 333 të shëruar dhe 529 raste me Covid në Kosovë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 MARS - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2 888 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 529 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar gjashtë raste të të vdekur si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Fushë-Kosovë dy raste (78, 62 vjeç), Drenas një rast (65 vjeç), Gjilan një rast (86 vjeç), Lipjan një rast (64 vjeç) dhe Prishtinë një rast (77 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive

është 74 748 raste nga 341 443 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 674 raste të të vdekurve.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 333 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 62 983 raste, kurse numri i rasteve aktive është 10 091.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 191 raste, Pejë 44 raste, Ferizaj 34 raste, Mitrovicë 33 raste, Gjakovë 32 raste, Gjilan 26 raste, Lipjan 21 raste, Obiliq 21 raste, Kamenicë 18 raste, Vushtrri 18 raste, Fushë-Kosovë 14 raste, Rahovec 13 raste, Istog 9 raste, Drenas 8 raste, Prizren 7 raste, Viti 7 raste, Deçan 6 raste, Junik 5 raste, Shtime 5 raste, Skenderaj 5 raste, Novobërdë 3 raste, Suharekë 3 raste, Klinë 2 raste dhe me nga një rast komunat Kaçanik, Klokot, Malishevë dhe Podujevë.



## KMDLNj, veteranëve të UÇK-së: Mos kaloni nëpër Serbi, mund të arrestoheni

PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) u ka bërë thirrje veteranëve të luftës së UÇK-së që mos të kalojnë nëpër Serbi sepse mund të arrestohen. "Një numër të tyre i ka mbajtur për muaj të tërë në paraburgim, kurse disa i mban edhe sot, me akuzë të sajura se kanë bërë krime lufte në Kosovë ndaj serbëve dhe komunitetit tjetër joshqiptar. Për shkak të marrëdhënieve të pavendosura midis shteteve dhe për shkak se zyra ndërlidhëse nuk ka pasur qasje në këto raste, të arrestuarit nga Kosova kanë mbetur nën mëshirën e avokatëve që iu kanë marrë shumën e mëdha parash. Republika e Kosovës, për shkak të rrethanave aktuale, nuk ka mundur t'u dalë në ndihmë të arrestuarve, ndërsa ndërkombëtarët kanë mbajtur një qëndrim neutral ndaj shqiptarëve të arrestuar, kurse zëshëm ka reaguar për serbët e arrestuar në Kosovë të akuzuar për krime lufte. Shqiptarëve të arrestuar në Serbi nuk mund t'u garantohet gjykimi i drejtë, i paanshëm dhe i pandikuar politikisht dhe, rrjedhimisht, as



mbrojtje efektive juridike. KMDLNj edhe më parë ka bërë thirrje publike që të gjithë ata, që në një mënyrë apo tjetër kanë qenë pjesë e UÇK-së, të mos kalojnë nëpër Serbi sepse mund të arrestohen gjë që

edhe ka ndodhur", ka njoftuar KMDLNj, duke theksuar se ka informata se Serbia e ka marrë komplet listën e veteranëve të luftës së ish-UÇK-së në mënyrë që, nëse iu ofrohet mundësia, t'i arrestojnë dhe t'i detyrojnë të

japin dëshmi të rrejshme apo t'i shndërrojnë në bashkëpunëtorë. "KMDLNj bënë thirrje publike që të gjithë ata që kanë qenë pjesë e luftës çlirimtare apo që e kanë ndihmuar luftën, në asnjë mënyrë të mos udhëtojnë

nëpër Serbi sepse lehtësisht mund të arrestohen dhe të kushtëzohen me lirim, në kundërvlerë të dhënies së informatave që i duhen Serbisë", është thënë në njoftimin e KMDLNj-së.

## Pas zgjedhjeve të 14 shkurtit, Hoxhaj nis vizitat nëpër degët e PDK-së



PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka nisur një tur vizitash nëpër të gjitha degët e PDK-së në Kosovë, për t'i

falënderuar për angazhimin e palodhshëm në zgjedhjet e fundit. Ai ka takuar anëtarët dhe kryesitë e degëve në Skenderaj dhe Drenas, ku ka diskutuar për punën që e pret

Partinë Demokratike të Kosovës. Hoxhaj është shprehur mirënjohës për punën dhe angazhimin e pandalur për PDK-në dhe për Kosovën.

## Konfiskohen 700 kilogramë mish në Ferizaj

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka ndërmarrë të martën një aksion për inspektimin e të gjitha mishtoreve në Ferizaj. Në kuadër të këtij aksioni janë konfiskuar 700 kilogramë mish dhe produkte të tjera mishi që nuk i plotësonin kushtet ligjore për tregtim

**EPOKA  
ERE**

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 MARS - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka ndërmarrë të martën një aksion për inspektimin e të gjitha mishtoreve në Ferizaj. Ky aksion i AUV-së është zhvilluar në bashkëpunim me inspektorët komunalë. “Nga ky aksion u konfiskuan një sasi prej 700 kilogramë mish dhe produkte të tjera mishi, e cila nuk i plotësonte kushtet ligjore për tregtim. Produktet e mishit të konfiskuar ishin: mish i freskët, mish i grirë, suxhuk, virshlle, mish i terur. E gjithë sasia u tërhoq nga shitja dhe u bllokua me urdhër të inspektorit. E gjithë sasia e mishit të ndaluar do të

asgjësohet në prani të inspektorëve kompetentë. Shumica e mishtoreve kishin kushte të mira higjienike, ndërkaq për hapësirat që kishte defekte u urdhërua që ato të përmirësohen brenda afateve kohore”, ka thënë për gazetën “Epoka e re” zëdhënësi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, Lamir Thaçi. Sipas tij, të gjithë operatorët të cilët tregtojnë produkte mishi duhet të jenë të regjistruara në AUV. “AUV përmes inspektoratit veterinar është duke ndërmarrë aksione në të gjithë Kosovën që t’i largojë nga tregu të gjitha produktet ushqimore me origjinë shtazore të cilat nuk i plotësojnë kriteret ligjore për sigurinë ushqimore. Të gjithë operatorët të cilët tregtojnë

produkte mishi duhet të jenë të regjistruara në AUV. Thertoret dhe përpunuesit e mishit duhet të jenë të licencuara për veprimtarinë përkatëse.

Hapësirat duhet t’i plotësojnë kushtet teknike sanitare dhe higjienike të cilat garantojnë siguri në prodhim, përpunim apo tregtim të produktit. Në të

gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor duhen plotësuar kushtet që produkti të konsumatori të shkojë i sigurt dhe cilësor”, ka theksuar Thaçi.

## Mbi 50 000 punëtorë kanë humbur vendet e punës

PRISHTINË, 10 MARS - Instituti “Paragon” ka mbajtur të mërkurën tryezë me temën “Ndikimi i pandemisë Covid-19 në tregun e punës, sfidat si dhe pritshmëritë”. Në këtë tryezë u bë me dije se si pasojë e pandemisë Covid-19 rreth 50 000 punëtorë kanë humbur vendin e punës, 10 000 biznese kanë falimentuar dhe 150 000 mijë punëtorë po kanë vështirësi ende në marrjen e

pagave.

Fisnik Dukolli nga Instituti “Paragon” ka thënë se pandemia ka prekur të gjithë sektorët dhe grupmoshat në vend, duke shtuar se ka pasur ndikim të madh në rënien ekonomike. “Pandemia edhe në vendin tonë ka ndikuar në rënien e ekonomisë. Nga kjo pandemi ka pësuar rënie edhe cilësia në sektorin e arsimit. Pandemia ka prekur të gjitha

grupmoshat për t’u manifestuar me mbyllje të bizneseve. Një punë e mirë është bërë, miratimi i Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Dhënia e pakove ka detyruar bizneset ta rritin numrin e funksionalizimit të punëtorëve”, ka thënë ai.

Florian Aliu, menaxher i hulumtimeve në Institutin “Paragon”, ka thënë se 10 000 biznese kanë falimentuar dhe

rreth 150 000 punëtorë ende po kanë vështirësi për marrjen e pagave. “Afër 50 000 punëtorë kanë humbur vendin e punës dhe 10 000 biznese kanë falimentuar dhe mbi 150 000 punëtorë hasin vështirësi për marrjen e pagave”, është shprehur Aliu.

Ndërkaq Arian Vranica nga Shoqata e Gastronomëve e Kosovës ka pohuar se ky sektor ka pasur humbje prej 20 milionë

eurosh. “Prej fillimit sektori i gastronomisë ka bërë një lloj kompromisi për mbyllje dhe prej asaj periudhe kemi rënie 64 për qind apo rreth 20 milionë euro dëme. 89 për qind e bizneseve deri në tetor të vitit të kaluar kanë punuar me humbje, mirëpo tani rrethanat kanë ndryshuar dhe nuk është si në 2020-n. Roli i shtetit gjatë kohës së pandemisë ka qenë shumë i mangët”, ka theksuar Vranica.





# OEAK-u: Ndërmjetësimi të përdoret si formë për zgjidhjen e kontesteve të punës

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka organizuar forumin virtual lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në vend të punës. Në këtë forum u konstatua se derisa gjyqtarët civilë janë të mbingarkuar me raste të ndryshme, të cilat nuk janë të profilizuara domosdoshmërisht vetëm në konteste të punës, është duke shkaktuar kështu vonesa për zgjidhjen e rasteve përkatëse

çështjet e punës, derisa tha se kontestet e kësaj natyre zakonisht janë të ndërlikuara dhe varen nga rasti në rast. Duke iu referuar statistikave të zgjidhjes së rasteve të marrëdhëniesve të punës brenda një viti në gjykatat e Kosovës, Hoti ka thënë se numri më i madh i lëndëve të pazgjidhura sa iu përket këtyre kontesteve ka të bëjë me çështjet e kompensimit të dëmit. "Gjithsej janë 6 580 lëndë, ndërsa të pazgjidhura kanë mbetur edhe 4 068 lëndë. Ndoshta ka ndikuar edhe pandemia por, sido që të jetë, numri më i madh i lëndëve është në aspektin e kompensimit të dëmit", është shprehur Hoti.

Më tutje, duke folur për përdorimin e metodave alternative të zgjidhjes së kontesteve të punëve, ai ka theksuar se zhvillimi i

procedurës së ndërmjetësimi do të ishte shumë atraktiv, sepse do ta shkurtonte kohën e zgjidhjes së kontesteve krahasuar me gjykatën.

Gjyqtari në Gjykatën Supreme, Shukri Sylejmani, ka theksuar se kontestet e punës llogariten si kontestet më të ndërlikuara në strukturën e kontesteve gjyqësore nga lëmi civil juridik. Ai ka folur edhe për zhvillimin e legjislacionit të punës përgjatë viteve, ku tha se për një kohë të gjatë i njëjti nuk ka qenë specifik në shumë instanca të rëndësishme, me theks të veçantë te procedurat disiplinore. Gjyqtari Sylejmani ka theksuar nevojën për reformë gjyqësore dhe profilizim të gjyqtarëve meqë, sipas tij, lëmi civil është shumë i gjerë.

Avokati Fisnik Salihu nga shoqëria e avokatëve RPHS Law ka theksuar nevojën për

ndryshim dhe plotësim të legjislacionit aktual të punës në aspekte të rëndësishme, të cilat deri më tani nuk kanë qenë të rregulluara, si dhe për balancim të interesave në mes të punëdhënësve dhe punëmarrësve. Gjithashtu, Salihu ka shtuar se është e nevojshme që të promovohen sa më shumë mekanizmat e zgjedhjes alternative të mosmarrëveshjeve për çështjet e punës, në mënyrë që të shmangen procedurat e gjata gjyqësore.

Gjatë kësaj ngjarjeje, mes të tjerash, u adresuan edhe çështje të tilla si arsyet mbrapa mosefikasitetit të gjykatave dhe vonesës në trajtim të çështjeve, rregulloret e brendshme të kompanive dhe respektimi i të drejtave të punëtorëve, si dhe sfidat nga legjislacioni aktual i punës për sektorin privat.

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 10 MARS - Zgjidhja e kontesteve të punës në Kosovë kryesisht bëhet përmes gjykatës, derisa gjyqtarët civilë janë të mbingarkuar me raste të ndryshme të cilat nuk janë të profilizuara domosdoshmërisht vetëm në konteste të punës, duke shkaktuar kështu vonesa në zgjidhjen e rasteve përkatëse. Kështu u tha në forumin virtual

lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në vend të punës, organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, ku pjesë e panelit të diskutimit ishin përfaqësues nga sektori privat, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykata Supreme.

Gjatë këtij forumi drejtori i Departamentit Ligjor në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Astrit Hoti, ka folur mbi legjislacionin rregullues për



## Pas reshjeve të borës, Ministria e Infrastrukturës intervenon në rrugë

PRISHTINË, 10 MARS (ER) - Ministria e Infrastrukturës (MI) ka njoftuar se, pavarësisht prej reshjeve të borës, rrugët janë të kalueshme për qarkullim të automjeteve. Sipas raporteve nga menaxherët e MI-së, rrugët që janë në menaxhim të këtij institucioni në vazhdimësi janë duke u pastruar nga bora dhe është duke u hedhur kripa me qëllim të parandalimit të ngricave. "Edhe rrugët në viset malore si Bajgorë, Kullë, Bogë e Prevallë janë të hapura për qarkullim të automjeteve", është thënë në njoftimin e kësaj ministrie. Ministria e Infrastrukturës ka bërë thirrje për kujdes të shtuar

nga të gjithë shoferët gjatë vozitjes, në përputhje me rregullat e komunikacionit dhe kushtet atmosferike, që të evitohen aksidentet e mundshme.


"Përkundër angazhimit maksimal të 14 kompanive në shtatë regjione dhe atyre që përkujdesen për autostradat, reshjet e vazhdueshme dhe era shkaktojnë borë në rrugë", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës.

Kjo ministri është përgjegjëse për pastrimin e rrugëve rajonale, nacionale, magjistrale, autostrada dhe jo për rrugët lokale të komunave.



Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (3)

# Nga marsi i madh i 1981-shit, Lëvizja Paqësore Çlirimtare u ngrit në një shkallë më të lartë



**Shkruan: Bedri ISLAMI**

Në Lidhjen Komuniste të Serbisë shkohej edhe më tej, duke gjetur një fajtor të dyfishtë: Tiranën zyrtare dhe një pjesë të udhëheqjes kosovare, e cila i kishte vënë bartësit e ngjarjeve të vitit 1981 në postet kryesore të institucioneve arsimore, shkencore e kulturore, çfarë, gjithnjë sipas qëndrimit zyrtar të politikës së lartë serbe, kishte ndikuar në "indokriminimin e rinisë në frymën e nacionalizmit dhe të irredentizmit shqiptar".

Për Lidhjen Komuniste të Kosovës plaga ishte e llahtarshme. Ajo që kishte ndodhur, për ata, ishte një lemeri e vërtetë. Duhet të fillonte një hetim i gjerë e duheshin gjetur me çdo kusht shkaqet e kryengritjes dhe burimi i tyre në Tiranën zyrtare por, më parë, ishte e domosdoshme të vendosej kordoni i ndëshkimit.

Do të fillojë një kalvar i pafund mbledhjesh, rezolutash, përgjashimesh, ndëshkimesh, dëbimesh, represioni në të gjithë piramidën e institucioneve të shtetit. E pamëshirshme do të ishte goditja ndaj bartësve të mendimit për Republikën e Kosovës, megjithëse këto të rinj të dënuar, të etur për dije, ëndërrimtarë të mëdhenj, lexues të pasionuar, dhe që synonin të bartnin një vizion që ishte shumë i madh për supet e tyre, të lënduar nga heshtja, synues të ngrinin një botë ndryshe, shpeshherë nuk kishin qenë të vetëdijshëm për peshën e asaj që kishte ndodhur, pasi e kishin quajtur gjithçka të natyrshme, njerëzore dhe të domosdoshme. Kur ata kishin thirrur se, "Trepça punon, Beogradi pasurohet" ndoshta nuk kishin qenë deri në fund të vetëdijësuar se po shpallnin pabarazinë e ndodhur kundër asaj që kishte trumbetuar pushteti dhe, ndërsa zëri i tyre ende i njomë dukej se nuk do të lëvizte as pragjet e shtëpive, në fakt kishte tundur themelet e një republike fantazmë, krijuar në kabinete, mbajtur me dhunë dhe që do të përfundonte përgjakshëm, aty ku nisi shthurja e saj - në Kosovë.

Është e pabesueshme sa përdhunshëm u soll ndaj tyre

klasa politike dhe Lidhja Komuniste e Kosovës, një filial i politikës së Lidhjes Komuniste të Serbisë.

Adem Demaçi ka thënë: Mendoj se kërkesat e kryengritësve paqësorë kanë qenë në pajtim me mundësitë dhe rrethanat kombëtare e ndërkombëtare të asaj kohe. Që nga Kryengritja paqësore e nëntorit 1968 në Kosovë, Lëvizja Çlirimtare, përsëri, kishte kaluar në ilegalitet. Por nga marsi i madh i 1981-shit, Lëvizja paqësore çlirimtare u ngrit në një shkallë më të lartë, mori rrugët e qyteteve tona. Dhuna e egër e regjimit çetnik, në vend se të gulfonte kryengritjen, i dha zjarr edhe më të madh dhe e bëri që ajo të masivizohej edhe më shumë. As burgosjet, as vrasjet nuk dhanë rezultate. Policia serbe u gjet e pafuqishme para furisë së masave të elektrizuara... Ajo kërkesë shprehte nivelin e vetëdijes dhe nivelin e organizimit tonë në atë kohë dhe rrethanat kombëtare e ndërkombëtare të asaj kohe. Sikur kryengritja paqësore e 1981-shit të kishte ndodhur më 1974, kur duhej të ndryshohej kushtetuta, kur Kosovën Republikë e patën përkrahur madje edhe Katerina Paternogiq-Cica, Milija Kovaçević, Smajo Jusufi e Rezak Shala e derisa ekuilibristi Tito ende ishte gjallë, Kosova do të arrinte të barazohej me republikat tjera të Jugosllavisë. Dhe kjo do të ishte një fitore e rëndësishme në rrugën tonë drejt lirisë së plotë. Por Fadil Hoxha dhe garnitura gjakovare në pushtet nuk e vlerësuan situatën drejt. Kësaj garniture rehatia e gjatë ia kishte thyer tehun e gatishmërisë për sakrificë. Ajo u përcaktua për rehatinë e vet duke menduar se kjo rehati do të zgjaste deri në infinit dhe prandaj flaku tej interesin e përgjithshëm...

Më 4 prill 1981 do të mbledhet me urgjencë Komiteti Krahinor i LKK-së. Është një mbledhje e tensionuar, ndoshta nga më të tensionuarat që nga koha e rankoviqizmit, në një sallë të mbyllur, ku zërat kundër dhunës janë aq të paktë dhe të heshtur, sa që nuk ndjehen fare. Prej kohe në Kosovë është instaluar një klasë politike që i kishte fillimet e jetës së tyre politike në Shqipëri. Disa nga më të njohurit e tyre, si Fadil Hoxha apo Veli Deva janë të dërguarit e parë të Partisë Komuniste të Shqipërisë, posaçërisht nga vetë Enver Hoxha, drejt Kosovës, për të organizuar aty, së bashku me Hajdar Dushin, Xheladin

Hanën, Emin Durakun luftën antifashiste nacional çlirimtare. Si të rinj, ata ishin pjesë e një bote vizionare, që, për më tepër, kishte pasur të njëjtën ëndërr si të rinjtë e vitit 1981, bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Tani, si drejtues politikë, thuajse 40 vjet pas vizionit të tyre të parë, gjithçka ka ndryshuar. Veli Deva, i cili çuditërisht është një ndër folësit kryesorë në varrimin e heroit shqiptar, Qemal Stafa, në maj 1942, thuajse 40 vjet më pas miraton vrasjet e burgimet.

Veli Deva, i njëjti si emër, i ndryshëm në frymë, udhëheqës i lartë i Kosovës në Mbledhjen e 86-të Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës, e mbajtur më 4 prill 1981, ka thënë: "Pushteti popullor kurrë nuk është rrezikuar më shumë dhe nuk është luhatur nga një aktivitet më i madh armiqësor sesa që ishte ky aktivitet".

Kurse Kolë Shiroka, koleg i tij, ndërkohë njëri ndër më agresivët kundër demonstruesve, i verbër në gjykimin e tij, ndaj edhe dritëshkurtër në mendim, po në këtë mbledhje pranonte: "Pra, planifikimi ka qenë i gjatë dhe kemi të bëjmë me një organizim dhe organizatë më të organizuar sesa organizata jonë".

Idetë e përgjithshme janë të urryera nga idetë e pjesshme;

këtu qëndron edhe vetë lufta e përparimit. Vizioni i hapur e çon shpirtin tek idetë e përgjithshme; mendjet e mbyllura pjellin ide shtatnike. Vizioni nuk është i njëjtë kur atë e lind vuajtja, ose kur e pjellin ujërat e ndenjura të mendimit. Është interesante, bartësit e kryengritjes së vitit 1981 kanë si simbol malin, pushtetarët politikë të vitit 1981 kanë si simbol pyllin. Në bartësit, dënimi i të cilëve sapo ka filluar, gjithçka është vizionare. Te pushteti errësira e vetmisë ka mbuluar shpirtin.

Këto njerëz janë thirrur për të dënuar pikërisht atë që kishin ëndërruar kur kishin qenë të rinj. Po dënonin në perëndimin e jetës së tyre, pikërisht atë që kishin pasur ëndërr në agun e rinisë.

Në fakt ishte një përplasje mes dy koncepteve: Krahinë dhe Atdhe. Pushtetarët ishin për Krahinën, kryengritësit për Atdheun. Është lufta e ideve lokale kundër ideve universale; janë zemrat e mëdha kundër mendjeve të ngushta.

Qindra arrestime ndodhin në krejt pak ditë. Askush nuk është më i sigurt. Mes të arrestuarve të parë është një emër i njohur, Ukshin Hoti. Fillon kalvari i arrestimeve të tij, që, në fakt, simbolizon arrestimin e mendjes së ndritur prej errësirës. Çdo natë thyhen dyer dhe drejt burgjeve tani nuk

shkohet më fillikat, por në grupe. Qelitë e tejmbushura, shumica djem e vajza të reja. E megjithatë, garnitura e vjetër kërkon përsëri gjakime të tjera. Më 13 prill 1981 Xhavit Nimani, në mbledhje të Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste, thoshte edhe këto: "[...] sot kemi biseduar, thanë se nuk kemi më vende në burgje".

Arrestimet e reja, në fakt ishin vazhdim i intensifikuar i ndjekjeve që i bëheshin në vijimësi Lëvizjes Kombëtare të Kosovës. Në një nga mbledhjet e Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës, fill pas demonstratave, Sekretariati i Punëve të Brendshme raportonte:

Ne kemi bërë një analizë nga viti 1974 e deri tash, ku bëhet fjalë për shtatë vjet. Nga kjo shihet qartë se ky shërbim i ka zbuluar nëntë grupe armiqësore...që e kanë pasur organizatën e tyre, i kanë pasur qëllimet e veta, dokumentet e veta dhe kështu me radhë. Ndër ta është një grup me pozicione të Informbyrosë, ky është i ashtuquajtur grupi Lidhja e Re Komuniste e Jugosllavisë. Të gjitha grupet tjera janë nga pozicioni i nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar.

Ndërkaq Mahmud Bakalli në Mbledhjen e 89-të të Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës, mbajtur më 27 prill 1981, duke folur për armikun e brendshëm, theksonte:

Ai ka vepruar edhe më herët, i ka pasur edhe aksionet e veta, ne e kemi ndjekur...e kemi penguar, respektivisht zbuluar...disa nga degët e tij i kemi zënë dhe i kemi dënuar vazhdimisht në dekadën e kaluar. ... [S]e për tërë dhjetë vjet sa qindra syresh i kemi zbuluar dhe me procedurë penale i kemi dërguar në burg me të njëjtën bazë. Por kurrë nuk kemi konstatuar se e kemi shkatërruar armikun dhe që ai nuk vepron. Ai vepron...sikur karikator i revoles, e heq njërin grup, formohet tjetri.

Pasi kanë kryer punë me të rinjtë, tani të burgosur, pasi kishin zbuluar nëntë organizata, bukur të mëdha dhe 93 grupe kundërrevolucionare, pushteti kthehet në vlerësimin e tij kryesor: bartësit e vitit 1981 janë të indoktrinuar nga Shqipëria dhe tashmë janë krijuar disa vatra që duheshin eliminuar. Në harkun kohor të pak muajve dënohen 1019 "kundërrevolucionarë". Më shumë se 44 për qind e tyre janë nën moshën 24 vjeçare. Megjithëse nuk jepet kurrfarë



shpjegimi se si mund të jenë indoktrinuar, megjithëse në gjyq të gjithë dënohen si bartës të idesë së republikës së Kosovës dhe nuk ka, veç fare pak, akuza për idenë e bashkimit me Shqipërinë. Shteti në Kosovë, drejtuar nga Beogradi, ka ndezur makinerinë e tij.

Vladimir Bakariq, një veteran dhe zyrtar i lartë jugosllav, edhe ky i befasuar, deklaronte: Dikush u ka prirë në mënyrë shumë profesionale këtyre demonstratave dhe është vështirë të thuhet se një Kosovë relativisht e prapambetur ka mundur të japë një nivel aq të lartë të organizimit sikurse ka qenë atje. Pra, jo në linjën komuniste, por në linjën antikomuniste.

Një funksionar i lartë serb në Kosovë, Dushan Ristiç lëshon thirrjen se, "kurrfarë librash nuk na duhen nga Shqipëria". Thirrje të tilla vijnë edhe nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, ku zërat kundër pavarësisë janë më të furishëm, por kësaj here fshehur pas dogmatizmit.

Fillon në pak ditë djegia e librave në shesh. Digjet Kadare, Agolli, Arapi, Kuteli, që është si i nëmur për poemthin kosovar, Poradeci është më i përkëdhelur, por prapë se prapë i djegur edhe ai; Fishta është i lëçitur dhe përgjithësisht shkrimtarët para vitit 1945 janë rreptësisht të ndaluar. Digjen veprat e Çabejt dhe të Budës, Demirajt dhe Arben Putos. Flakadanë të mëdhenj ndizen në sheshet e Prishtinës.

Një fushatë sulmesh të egra, të denja për Mesjetën, u organizua kundër kulturës, historisë, arsimit dhe inteligjencës shqiptare. Pas vënies së 'murit të hekurt' midis Kosovës dhe Shqipërisë, u hoqën nga shkollat e fakultetet tekstet që kishin ardhur nga andej dhe të gjitha të tjerat me përmbajtje kombëtare. Librat shqip digjeshin në grumbull si në inkuizicione mesjetare.

"Atje ku digjen librat, në fund digjen edhe njerëzit", thoshte Heine.

Befas do të fillonin sulmet e ashpra kundër gjuhës letrare të unisuar shqipe. Jusuf Gërvalla, pa dyshim një ndër figurat më të shquara dhe të realizuara të brezit të vitit 1981, i vrrarë më 17 janar 1982, së bashku me militantin e pazakontë, Kadri Zeka dhe të vëllanë, Bardhosh Gërvalla, në një qytezë pranë Shtutgartit, do të vërente që asaj kohe se: "Shtypi jugosllav, veç të tjerash, 'merakoset' edhe për gjuhën tonë të njësuar letrare. Pse - thonë letërnxirësit e gazetave të shumta, - kur u bë unisimi i shqipes, nuk u mor për bazë gegërishtja po toskërishtja! Bile, toskërishtja gjirokastrite- shtojnë ata - e folmja e vendlindjes së Enver Hoxhës". (Vijon)

# Jo propagandë, shtimi dhe shpejtimi i vaksinimit janë politika më e mirë ekonomike e sociale



Prof. Lisen BASHKURTI

Shqipëria është në një krizë të thellë ekonomike dhe sociale shkaktuar nga politikat konfuze publike, nga goditja e rëndë e tërmetit në nëntor 2019 dhe nga pandemia Covid-19. Fushata zgjedhore politike e 25 prillit 2021 vetëm e ka rënduar këtë situatë. Shpresa për ndryshim është e madhe dhe në rritje. Por deri atëherë vendi gjendet pa qeverisje. Dhe, dihet se qeverisja më e keqe është mosqeverisja.

Ndërkohë që politika në fushatë elektorale ka ndezur gjithë motorët e saj drejt 25 prillit, duket se një garë e nxehtë është përqendruar te mëkëmbja ekonomike e vendit dhe adresimi i problemeve sociale të tij. Gara duket edhe në ofrimin e shifrave për eliminimin e varfërisë, përmes rritjes së pagave minimale dhe pensione; rritjes së punësimit, përmes investimeve të brendshme e të huaja: përmirësimit të klimës së biznesit, përmes vendosjes së taksës së sheshtë dhe në përgjithësi uljes së taksave dhe tatimeve dhe lehtësimit të procedurave në këtë aspekt; adresimit të problemeve madhore sociale, përmes reformave radikale në shëndetësi, arsim etj.

## 1. Pandemia, si po adresohet në botë

Pa folur për pasojat dramatike e shpesh tragjike në jetë njerëzore të pandemisë, gropa e krijuar prej saj po zmadhohet e thellohet duke e varrosur ekonominë dhe shoqërinë shqiptare. Edhe të verbëritë e shohin këtë, edhe të shurdhrit e dëgjojnë, por vetëm politika zyrtare, pra qeveria qendrore dhe vendore nuk po e ndjejnë, ose po përpiqen ta kamufllojë me propagandë.

Në gjithë botën katastrofa pandemike ka varrosur ekonominë dhe ka shkaktuar plagë sociale. Krahasuar me periudhën para pandemie afërsisht më shumë se 10 milionë njerëz kanë humbur vendet e punës vetëm në

vendet e OECD-it, ku bëjnë pjesë 36 vendet më të pasura të botës.

Në vendet më të varfra, ku bën pjesë edhe Shqipëria, papunësia është akoma më e madhe dhe në rritje, plagët sociale gjithashtu. Kjo shpjegon faktin se edhe në këtë kohë pandemie kërkesat e shqiptarëve për azil janë të mëdha, madje nga më të mëdhatë në botë.

Rritja e papunësisë në Shqipëri, thellon varfërinë në vend, rriten nivelin e jetesës së njerëzve, ulë kërkesën për konsum, dobëson prodhimin, tregtinë dhe shërbimet që varen nga kërkesat e njerëzve. Rritja e papunësisë, pra, godet fatalisht gjithë sektorët ekonomik dhe social të vendit. Në këtë krizë nga duhet kapur filli?

## 2. Shtimi dhe shpejtimi i vaksinimit, politika më e mirë

Bazuar në mendimet më të avancuara të ekspertëve të krizave ndërkombëtare që po merren intensivisht edhe me krizën globale pandemike, mendohet gjerësisht se rimëkëmbja më e mirë dhe më e shpejtë ekonomike varet kryekëput nga masa dhe shpejtësia e vaksinimit të popullsisë. Çdo zhvendosje tjetër në prioritetet e politikave publike është e pasaktë dhe e gabuar. Çdo zhvendosje prioritetesh zgjatë pandeminë dhe për rrjedhojë gjithë pasojat komplekse të saj.

Duke analizuar krizën aktuale pandemike Laurence Boone, eksperte në Grupin e Parisit Chief Economist, thotë se... "Politika më e mirë ekonomike sot është të vaksinohen më shumë dhe më shpejtë. Nëse ne jemi në

luftë me virusin, ne duhet t'i japim vetes gjithë burimet e kohës së luftës për prodhimin dhe shpërndarjen e vaksinës".

Këtë prioritizim për rritje dhe shpejtësim të vaksinimit si rruga e vetme, më e mira dhe më e sigurta edhe për mëkëmbje ekonomike dhe sociale e provojnë vende si Izraeli që kanë vaksinuar shpejt një numër të madh popullsie. Deri me 8 mars 2021 Izraeli ka vaksinuar thuhet 58 për qind të popullsisë, gjë që e ka ndihmuar të heqë kufizimet për lëvizjen e njerëzve dhe veprimtaria ekonomike është duke marrë rrugën e ripërtëritjes së shpejtë. Gjithashtu, këtë po tregon edhe përvoja e vaksinimit të madh dhe të shpejtë në ShBA, të cilat deri në fillim të marsit 2021 kanë vaksinuar 18 për qind të popullsisë. Sikundër në Mbretërinë e Bashkuar ku janë vaksinuar afro 33 për qind e popullsisë. Ndërkohë masë dhe ritme më të ulëta vaksinimi kanë Gjermania dhe Franca, diku mbi 6 për qind të vaksinimit të popullsisë.

Situata e masës dhe shpejtësisë së vaksinimit në Shqipëri është, e duhet thënë pa kurrfarë hezitimi, katastrofale. Numri i vaksinave është fare-fare i papërfillshëm për numrin e popullsisë, aq sa nuk i afrohet gjëkund as 1 për qind numri total të popullsisë. Janë vaksinuar vetëm bluzat e bardha dhe një grup shumë i vogël të moshuarish. Ndërkohë që edhe rrjeti i kushteve të vaksinimit është tejet i kufizuar dhe i mangët. Përkundrajt kësaj situatë dramatike-tragjike për popullsinë, shëndetin, ekonominë e jetën sociale të vendit, Qeveria parashikon skenarin më të mirë

realizimin e vaksinimit të plotë në 14 muaj, e në skenarin më të keq në dy vjet. Ndonëse janë skenarë në ajër, pa tregues, kontrata, marrëveshje dhe përgatitje paraprake kushtesh vaksinimi si dhe pa një kalendar të mirë-menduar e transparent për target-grupet që duhen vaksinuar prioritarisht, të dy skenarët propabël të qeverisë janë të trishtuar.

Limitet e kufizuara dhe shpejtësia e ulët e vaksinimit të popullsisë shqiptare do e mbajnë krizën pandemike gjallë e për pasojë do të rriten rastet e sëmundshmërisë dhe të fatalitetit herë pas here. Gjithashtu, do të zmadhohet dhe thellohet gropa ekonomike e sociale e vendit dhe zgjatja e pasojave të saj në kohë të paparashikuara.

Shkaktarë të kësaj situatë katastrofale është verbëria e politikës shëndetësore të Qeverisë Rama, vonesat në adresimin e kontraktimeve dhe likuidimeve financiare paraprake të vaksinave, paparashikueshmëria e situatës pandemike në vend, mos përgatitja për variante alternative si dhe e mangësitë në ngritjen e network-ut të përshtatshëm për vaksinim. Në vend të përpilimit dhe aplikimit të politikave efikase dhe efçente shëndetësore vaksinuese masive dhe të shpejta, qeveria Rama bën një plan veprimi propagandistik me ecejake nga Tirana në Aeroportin e Rinasit e prej atje nëpër stadiumet e Shqipërisë ku janë krijuar disa poste vaksinimi për grupe të papërfillshme njerëzish. Ngrëhina e propagandës nuk e mbulon dot gropën e madhe dhe të thellë që po zmadhohet çdo ditë duke rroposur jetët njerëzore, ekonominë dhe aspektet sociale të vendit.



# KTHIMI



ELIFE LUZHA

Me rreze yjesh rimova këngën time  
Viteve të zehërta degdisur në mërgim  
Ankthin e rënies ndjerë e kam gjer në rrënjë  
Rrathëve të ajrit ngulfatur me durim

Dhe ja tek jam tani përballë teje malli im  
Guri i sertë i pritjes para kumtit hesht  
Peshë e halleve tua shpresën ma gurëzon  
Djallëzitë kthinave danteske gjarpërojnë

Ti balldiell shndrit në rrugëtim me parzëm mprehur  
Mijëra vjet logjeve dardane lumit gjakut jemi rritur

Heu Kosovë këngë e paepur përjetësie ta puthi ballin  
Je bardhësi e agut ajër që frymon shqim dejve të mi

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

# Prishtina merr kryesimin në Superligë



Klubi kryeqytetas, Prishtina, është ngritur përkohësisht në vendin e parë të Superligës, pas fitores të madhe që mori ndaj Besës. Dy ndeshjet e tjera që u zhvilluan të mërkurën Llapi - Drenica dhe Trepça '89 - Feronikeli përfunduan pa fitues

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 10 MARS** - Skuadra e Prishtinës e ka shkatërruar Besën e Pejës, pasi e ka mposhtur të mërkurën në stadiumin "Fadil Vokrri" me rezultat 5-1. Në minutën e 14-t Leonit Abazi e kaloi skuadrën kryeqytetase në epërsi 1-0. Shtatë minuta me vonë Endrit Krasniqi realizoi për 2-0. Pas tridhjetë minutave lojë, vjen edhe goli i tretë për vendësit të cilin e realizoi sulmuesi Leotrim Kryeziu. Në fillim të pjesës së dytë, Besa realizoi golin e parë nëpërmjet Sheqerollit dhe kjo ishte e tëra që e arriti klubi pejan në këtë ndeshje. Prishtina më pas realizoi edhe dy gola nëpërmjet Mankenda dhe Prapashtica, duke e vulosur rezultatit final 5-1. Pas tri pikëve të fituara, Prishtina është në vendin e parë me 30 pikë, derisa Besa vazhdon të jetë e fundit me vetëm 7 pikë.

Gjashtë gola janë shënuar në ndeshjen Llapi - Drenica, e cila është zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" dhe ka përfunduar me rezultat 3-3. Drenica e ka lëshuar fitoren nga duart në ndeshjen ndaj Llapit, pasi kishte dy gola avantazh. Mirëpo kuqezinjtë nuk u treguan aq të vëmendshëm dhe në fund është dashur të kënaqen me një pikë. Llapi kaloi i pari në epërsi me eurogolën e Ramadanit në

minutën e 24-t, kurse Drenica shënoi dy gola të shpejtë për ta përmbyllur pjesën e parë me rezultat 1-2. Autorë ishin Gjoni dhe Uka (1-2). Në minutën e 75-t, Cikani realizoi golin e tretë për mysafirët. Vendësit nuk u dorëzuan dhe arritën ta barazojnë rezultatit 3-3, kurse golat i shënuan Hoti dhe Januzi. Llapi pozicionohet në vendin e shtatë me 27 pikë, kurse Drenica është e parafundit me 25 pikë.

Ndeshja tjetër në mes të Trepçës '89 dhe Feronikelit përfundoi me rezultat 0-0. 89-shi renditet në pozitën e pestë me 32 pikë, kurse "Nikli" është një pozitë me poshtë me 28 pikë.

**Sot zhvillohen Drita - Gjilani dhe Arbëria - Ballkani**

Sot (e enjte) zhvillohet derbi i xhiros në mes të Dritës dhe Gjilanit. Rivaliteti i dy skuadrave gjilanase është i madh dhe vlerësohet si derbi më i madh në futbollin e Kosovës. Drita edhe në këtë edicion ka formë më të mirë, sepse është në vendin e parë dhe synon mbrojtjen e titullit. Në anën tjetër Gjilani, edhe përkundër investimeve dhe ndryshimeve në shtabin teknik, është jashtë garës për titull dhe Kupë. Të mërkurën zhvillohet edhe ndeshja në mes të Arbërisë dhe Ballkanit.

SHKURT

## E ardhmja e Strakoshës, larg Lazios

E ardhmja e Thomas Strakoshës mund të jetë larg Lazios. Sipas asaj që shkruan e përditshmja "Il Messaggero", përfundimi i kontratës të portierit të kombëtares kuqezi është në qershor të vitit 2022 dhe gardiani nuk ka më dëshirë ta rinovojë kontratën me kryeqytetasit. Me shitjen e tij, Lazio pritet të ketë një plus të madhe duke e parë se e bleu për një shifër prej 75 mijë eurosh nga Panionios. Duke parë se aktualisht portieri 25-vjeçar është një zgjedhje e dytë e trajnerit Simone Inzaghi, vlera e 30 milionë eurove të kartonit të tij duket tepër i shtrenjtë, por deçizive pritet të jetë nëse mund të jetë protagonist në sfidat e mbetura me bardhekaltrit për të parë nëse vlera e tij mund të rritej përsëri.

## Marku: Mezi pres të kthehem në Shqipëri dhe të luftoj si boksier

Florian Marku e nisi si luftëtar i MMA-s, por tashmë mund ta quajmë një boksier, madje të pamposhtur. Ai dëshiron një titull kampion bote dhe është në rrugën e duhur. Pas fitores me KO ndaj Charltonit, Marku u shpreh se ndeshja e tij e radhës do të jetë në një pallat sporti i mbushur plot dhe do të dëshironte të ishte në Shqipëri. Në një postim të publikuar në "Facebook" lushnjari lë të kuptohet se kjo dëshirë është arritur. Ai ka publikuar një foto nga ndeshja e fundit në Shqipëri si luftëtar i MMA-s dhe shprehet se mezi pret të kthehet e të luftojë si boksier. "Herën e fundit që luftova në Shqipëri isha një luftëtar i MMA-s. Mezi pres të kthehem në Shqipëri për luftën time të ardhshme si boksier", ka shkruar Marku.

## Istogu fiton turneun ndërkombëtar në Gjakovë

KHF Istogu ka fituar turneun ndërkombëtar për hendbolliste që u mbajt në Gjakovë. Turneun tradicional për festat e marsit e organizoi KHF Shqiponja. Pos Shqiponjës e Istogut morën pjesë Çairi i Shkupit dhe Nikshiqi i Malit të Zi. Në gjysmëfinale, Istogu fitoi ndaj Çairit, kurse Nikshiqi e mposhti skuadrën nikoqire, Shqiponjën. Në finale, Istogu fitoi ndaj Nikshiqit me rezultatit 28:17. Esmë Muratović është shpallur hendbollistja më e mirë e turneut.

SUPERLIGA - Java e 24-t

Trepça '89 - Feronikeli	0-0
Llapi - Drenica	3-3
Prishtina - Besa	5-1

Të enjten takohen:  
13:00 Drita - Gjilani  
13:00 Arbëria - Ballkani

Tabela

1. Prishtina	24	47 pikë
2. Drita	23	
3. Ballkani	23	48
4. Gjilani	23	
5. Trepça '89	24	
6. Feronikeli	24	28
7. Llapi	24	27
8. Arbëria	23	26
9. Drenica	24	25
10. Besa	24	7

LIGA E PARË

Grupi A

Istogu - A&N	3-2
Drenasi - Onix Banja	4-2
Vëllaznimi - Trepça	0-0
Të enjten takohen: Liria - Malisheva Vushtrria - Dukagjini	

Grupi B

Ramiz Sadiku - 2 Korriku	1-0
Flamurtari - Ulpiana	0-1
Dardana - KEK-u	1-0
Vllaznia (P) - Kika	1-0
Të enjten takohen: Ferizaj - Vitia	

## Shala: FBK-ja synon ta zhvillojë basketbollin ndër vajza në vendet rurale të Kosovës

PRISHTINË, 10 MARS - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) është e vendosur që të punojë në masivizimin e basketbollit femëror dhe mbështetja nga FIBA Evropa nëpërmjet projekteve të tilla si FIBA Europe Girls Program dhe kampanja "Her World, Her

Rules" është rruga e duhur për të arritur këtë qëllim. Nëpërmjet kampanjës "Her World, Her Rules", FBK-ja synon ta zhvillojë basketbollin ndër vajza në vendet rurale të Kosovës, apo edhe në qytetet ku nuk ka aktualisht ekipe të femrave të basketbollit. "Ne

kemi nevojë për shumë femra të bëhen trajnere dhe mentore. Ne kemi nevojë për sa më shumë lidere, pra që sa më shumë femra të përfshihen në sport, sepse vetëm në këtë mënyrë vajzat e reja do të qëndrojnë në sport", ka thënë Shala.



## 'Tifozat Kuq e Zi', Qeverisë së Shqipërisë: Hapeni stadiumin për sfidën ndaj Anglisë

Tiranë, 10 mars - Në prag të ndeshjes kundër Anglisë në "Ait Albania" tifo-grupi më i famshëm i kombëtares sonë, "Tifozat Kuq e Zi", i kanë kërkuar zyrtarisht qeverisë që të jenë të pranishëm. Sipas tyre, mund të shqyrtohet mundësia e hapjes së stadiumit në masën 30 për qind. "Duke marrë parasysh që kombëtarja jonë është pranë një cikli kualifikues mjaft të rëndësishëm, gjithashtu duke pasur parasysh fillimin e vaksinimit kundër Covid-19. Kërkojmë nga qeveria shqiptare të bëjë të mundur lejimin e pjesëmarrjes së tifozëve nëpër ngjarje sportive. Jemi të vetëdijshëm për situatën me pandeminë, po ashtu jemi dëshmitarë të shumë vendeve me statistika më të rënduara me Covid-19 që kanë lejuar



pjesëmarrjen e tifozëve në masën 30 % të kapacitetit të stadiumit (sipas udhëzimeve dhe protokolleve të UEFA-së dhe autoriteteve shëndetësore). Me këtë rast kërkojmë nga FSHF që të

shtojë presionin tek autoritetet shtetërore, që ndeshjet e ardhshme të kombëtares të luhen me praninë e lojtarit të 12-të", thuhet në komunikatën e lëshuar nga tifozët Kuq e Zi.

## Vettel: Synoj titullin e pestë në Formula 1

HEPPENHEIM, 10 MARS - Pasi fitoi katër tituj kampionë radhazi me Red Bullin gjithkush mendoi se piloti gjerman Sebastian Vettel shumë shpejt do ta thyente edhe rekordin e idhullit të tij, Michael Schumacher. Gjithsesi, kjo gjë nuk ndodhi, edhe pse ai garoi me Ferrarin, ku titulli i pestë kampion bote në Formula 1 mbeti një tabu për të dhe "kokëkuqen". Këtë sezon Vetteli do të garojë me Aston Martin në Formula 1, një makinë me pak përvojë. Megjithatë, piloti gjerman nuk heq dorë nga ëndrra e tij. "Pavarësisht prej moshës, mendoj se kam ende shumë kohë në dispozicion për ta fituar titullin e pestë në Formula 1. Gjithsesi, gjithçka do të varet se si do të shkojnë gjërat në të



ardhmen", ka thënë Vettel. Pra, nëse Aston Martin do t'i ofrojë një makinë fituese, ai është gati të duelojë për fitoren. "Në Formula 1 është e rëndësishme që ta kesh me vete makinën dhe skuadrën,

që të mbështesin në çdo moment. Vitet e fundit vetëm nëse garoje me Mercedes mund ta fitojë titullin. Me Ferrarin nuk iu afruam asnjëherë titullit", ka deklaruar Vettel.

### SHKURT

#### Unitedi mendon për Oblakun

Manchester Unitedi është në kërkim të një portieri të ri për sezonin e ardhshëm, kurse synim kryesor është Jan Oblaku i Atletico Madridit. David De Gea në fund të sezonit do të largohet nga "Old Trafford" dhe portieri sloven Oblak shihet si zëvendësim ideal. Klauzola e Oblakut është 100 milionë eurove, por Unitedi po mendoj të ofrojë De Gean për të ulur këtë çmim.

#### Juan Jesus infektohet me Covid

Rast i ri me koronavirus në Serinë A. Këtë herë është Juan Jesus i cili ndalet dhe futet në izolim për disa ditë, pasi ka rënë në kontakt me një pozitiv. Tamponi i mbrojtësit brazilian ka rezultuar gjithashtu pozitiv, kështu që futbollisti do ta vazhdojë periudhën e karantinës, me qëllim që të shmangen infeksionet e mëtejshme brenda grupit verdhekuq. Tamponët e tjerë të kryer te Roma ishin të gjithë negativë. Juan Jesus ka bërë vetëm 11 paraqitje, nga të cilat 6 në fazën e grupeve të "Europa League" dhe katër në kampionat. Asnjëherë titullar.

#### Liga e Kampionëve mbetet një mallkim për Juventusin, Ronaldo drejt largimit

Liga e Kampionëve mbetet një mallkim për Juventusin, nuk ka asnjë efekt as kura Cristiano Ronaldo. Ylli portugez u transferua në Torino me një qëllim të qartë, të fitonte kupën me "veshë të mëdhenj", atë që dinte të bënte më mirë, por për të tretin vit radhazi "Zonja e Vjetër" largohet e dëshpëruar. Fillimisht Ajax në fazën çerekfinale, më pas Lyon dhe Porto në 1/8, tre eliminime të turpshme që vendosin në pikëpyetje të madhe projektin e bardhezinjve. I pari që mund të largohet në fund të sezonit është pikërisht Ronaldo, pasi pa paratë e Ligës së Kampionëve është e vështirë të përballosh një pagë prej 31 milionë eurosh në sezon, aq më tepër që edhe në Serinë A nuk janë më favorit për të fituar. As vetë Ronaldo nuk do t'i pëlqente të kalonte edhe një tjetër vit, të katërtin, në një klub që nuk e plotëson egon e tij për të fituar edhe një herë garën më të fortë.

#### 'Maracana' do ta marrë emrin e legjendës Pele

Deputetët e Asamblesë Legjislative të shtetit të Rio de Janeiro miratuan në emergjencë projektligjin për ndryshimin e emrit zyrtar të stadiumit "Maracana" nga "Mario Filho" në "Edson Arantes do Nascimento - Rei Pele". Projektligji ka nevojë ta marrë miratimin e guvernatorit në detyrë, Claudio Castro, për t'u bërë ligj. Andre Ceciliano, një anëtar i asamblesë legjislative të Rios, deklaroi: "Mario Filho ishte një gazetar jashtëzakonisht aktiv në sektorin e sporteve. Pele ishte lojtari më i mirë i të gjitha kohëve në planet. Ai ka përfaqësuar Brazilin. Nuk kam dyshim se 'Maracana' do të vazhdojë të quhet njësoj".

## Qeveria japoneze ndalon tifozët e huaj për Lojërat Olimpike

Lojërat Olimpike dhe Para-Olimpike, të parashikuara për t'u mbajtur në Tokio këtë verë, pritet të zhvillohen pa praninë e tifozëve të huaj. Lajmin e jep një agjenci e njohur lajmesh në Japoni, që citon burime brenda qeverisë dhe komitetit organizativ. Situata e

krijuar nga koronavirusi dhe frika se ardhja e njerëzve nga vende të ndryshme të botës do ta shtojë edhe më shumë numrin e të prekurve e madje mund të nxjerrë nga kontrolli situatën, ka detyruar qeverinë japoneze të marrë këtë vendim. Në ditët e ardhshme

pritet një tjetër takim mes organizatorëve të Lojërave Olimpike e atyre Para-Olimpike, ku do të diskutohet edhe vendimi që pritet të komunikohet zyrtarisht në fund të këtij muaji. Lojërat Olimpike të Tokios duhej të mbaheshin verën e kaluar, por u

shtynë për shkak të koronavirusit, ndërsa këtë verë pritet që në impiantet sportive të ketë vetëm tifozë japonezë. Kjo do t'i ulte jo pak të ardhurat që qeveria japoneze kishte parashikuar të përfitonte nga kjo ngjarje, megjithatë rreziku i përhapjes më

të madhe të koronavirusit duket se ka justifikuar këtë vendim. Lojërat Olimpike të Tokios do të zhvillohen nga data 23 korrik deri më 8 gusht, ndërsa ato Para-Olimpike do të startojnë më 24 gusht dhe do të zgjasin deri më 5 shtator.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

**AGRON SHALA**

**DEKALOGU**

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €



Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

**Daut Dauti**  
**NJË PALË KËPUCË NË BERLIN**

novelë





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë  
për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 507/21 të datës 05.02.2021, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomandë:**

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor

Suzana.goranci@rks-gov.net

Telefon: + 381 38 200 32 553

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “METI” SH.P.K. Njomza Sahiti Gjilan, ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 810165549 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “METI” D.O.O. Njomza Sahiti Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810165549, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “METI” L.L.C. Njomza Sahiti Gjilan, has come to the decision to quit its nr. 810165549, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Emrah Sylja shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani"

► Fatime Tahiri shpall të pavlefshme diplomën e SHMLM " Dr. Xheladin Deda" ( Ish Desa Tomoviq).

► Burim Voca shpall të pavlefshme certifikatën e lëshuar nga qendra për aftësim profesional në Mitrovicë, kursi Metal.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studentë, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

